

KËRKESË
Nr. 2869, datë 16.5.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga zbatimi i projektit “Riveshje-sistemim-asfaltim-masa inxhinierike, rruga Këlcyrë-Përmet (Loti 3)”, për pasuritë e llojit “pyll”.

Subjekti kërkuar, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vemë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentat përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “pyll”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 740 500 (shtatëqind e dyzet mijë e pesëqind) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Bahri Shaqiri

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRI E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që preken nga zbatimi i projektit “Riveshje-sistemim-asfaltim-masa inxhinierike, rruga Këlcyrë-Përmet (Loti 3)

PRONARI				Z.Kad.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	“Sip.totale m2	Sip.e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera totale (lekë)	Shënime
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Bashkëpronarët Haxhiaj			2330	53/1	Pyll	15000	7405	100	740500	Konfirmuar nga ZVRPP
		SHUMA 740500									